



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2195 prot.

Tiranë, më 31.07.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1161/9, DATË 16.02.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASIT ZNJ. METIJE ALLA DHE Z. LULZIM ALLA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të paraqitura nga znj. Metije Alla dhe z. Lulzim Alla me nr. 1161 prot., datë 13.04.2023, nr. 1161/1 prot., datë 12.04.2023, me nr. 1161/2 prot., datë 18.04.2023, me nr. 1161/3 prot., datë 24.04.2023 dhe me nr. 1161/4 prot., datë 24.04.2023 në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit A.K. me detyrë drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1161/9 prot., datë 16.02.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasit znj. Metije Alla dhe z. Lulzim Alla”, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh”, neni 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Don Bosko”, Vizion Plus, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

